

**V E N D I M**

**Nr. 47 Date 18.04. 2008**

**PER**  
**NDRYSHIMIN E LICENSES SE SHOQERISE PROJEKSION SH.P.K**


Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, nenit 15 te “Rregullores per Procedurat e Licensimit” te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, dhe Vendimit te Bordit te Komisionereve nr.14, date 04.02.2008 “Per fillimin e procedurave per modifikimin e licenses per prodhimin e energjise elektrike me Nr 40, Seria PV06P” , Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.04.2008, mbasi shqyrtoi kerkesen e shoqerise Projeksion Energji sh.a per ndryshimin e licenses per prodhimin e energjise elektrike me Nr 40, Seria PV06P, leshuar me vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s nr. 76, date 07.11.2006, shoqerise Projeksion sh.p.k, dhe konstatoi paraqitjen e plote nga shoqeria Projeksion Energji sh.a, te dokumentacionit te kerkuar nga ERE,

**Vendosi**

1. Të miratoj kerkesen e shoqerise Projeksion Energji sh.a per ndryshimin e licenses Nr.40 seria PV06P, leshuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr.76, date 07.11.2006 shoqerise Projeksion sh.p.k.
2. Ne licensen me Nr. 40 seria PV 06P, ne pjeset ku percaktohet subjekti te cilit i jepet Licensa ndryshohet subjekti Projeksion sh.p.k dhe vendoset emertimi i subjektit Projeksion Energji sh.a. si dhe te dhenat e kesaj shoqerie lidhur me Kodin Fiskal dhe Certifikaten e Rregjistrimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



3. Kudo ku ne license percaktohet Projeksion sh.p.k si mbajtes i licenses pjeset e licenses shfuqizohen dhe hyjne ne fuqi ndryshimet sipas pikes 1, te ketij vendimi.
4. Ne pjeset e licenses se dhene shoqerise Projeksion sh.p.k, ku percaktohen data e hyrjes ne fuqi te licenses, ne vazhdim te numrit te vendimit te percaktuar ne licensen nr. 40 Seria PV06P shenohen edhe ndryshimet e ketij vendimi si pasoje e vendimmarrjes se Bordit te Komisionereve te ERE-s me date 18/04/2008.
5. Shoqerise Projeksion Energji Sh.a ti leshohet licensa me permbajtjen e ndryshuar sic percaktohet ne kete vendim.
6. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje shoqerite Projeksion Energji sh.a dhe Projeksion sh.p.k per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Napravishta**